



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

**SHBALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

Njoftim për vënd pune të lirë në administratë në pozicionin përgjegjës të sektorit në Sektorin e Prokurimeve Publike, në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroria e Përgjithshme, shpall konkurrimin për nëpunës civil të kategorisë ekzekutive III-a, për vëndin e punës në pozicionin “Përgjegjës sektori”. Proçedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe periudha e provës do të realizohet:

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë e ulët drejtuese) aplikohet në të njëjtën kohë!

Data e dorëzimit të dokumentave: 01.04.2024

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***

- Në aftesitë individuale, profesionale bazuar në jetëshkrimin, që konsiston në nivelin e llojit të arsimimit, përvjes, trajnimeve lidhur me fushën, si dhe vleresimet e arritjeve vjetore;

a) Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

i. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim

- Sekretari i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimit të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim

- Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet në S.B.Nj dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit PP dhe në hyrjen kryesore të Prokurorisë së Përgjithshme.

- Kandidatet, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsytet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet në S.B.Nj e cila njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.

- Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Sekretarit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve kalanderike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi mer përgjigje brënda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës

ii. Faza e dytë përbehet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore

- Vlerësimi me shkrim.

- Intervista e strukturuar me gojë.

b) Për pranimin në shërbimin civil, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.

- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këti ligji.

- Kandidatët të cilët kanë punuar në administrate publike të jenë vlerësuar tre vitet e fundit “shumë mirë”

c) Kërkesat e veçanta të grupit të administrimit të posaçëm janë:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar në Fakultetin Juridik me diplomë të nivelit Master shkencor.

- Të ketë përvojë pune, jo më pak se 10 vjet dhe prioritet është përvoja e punës që konsiston me detyrat kryesore të ngjashme që do të kryejë në këtë pozicion pune.

- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

- Të ketë aftësi të mira menaxhuese.

d) Vendi i punës në pozicionin pozicionin “përgjegjës sektori” ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesor;

- a) organizon dhe drejton punën në Sektorin e Prokurimit Publik;
- b) kryen bashkërendimin e punës me institucionet e varësisë së Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me prokurimet;
- c) koordinon punën me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme për hartimin e specifikimeve teknike, si fazë e parë për shpalljen e procedurës së prokurimit;
- ç) në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime është përgjegjës për sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion për dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve të prokurimeve publike për Prokurorinë e Përgjithshme;
- d) siguron që mbajtja dhe arkivimi i të dhënave të sektorit është në përputhje me kërkesat dhe rregullat për dokumentacionin e prokurimit publik;
- dh) monitoron dhe rishikon aktivitetet e prokurimit dhe dokumentet e tenderit, në ënyrë që të sigurojë që procedurat dhe kontrolli përkatës të jenë të zbatuara në kohën e duhur nga specialistët e sektorit;
- e) në fund të vitit ndjek dhe mbikëqyr hartimin dhe dorëzimin e Regjistrit përmbledhës për realizimin e prokurimeve publike në përputhje me afatet e parashikuara në ligj;
- g) jep asistencën e nevojshme autoriteteve kontraktore të varësisë për procedurat e prokurimit dhe për zbatimin me përpikmëri të legjislacionit në fuqi;
- gj) kryen funksione të tjera të caktuara me urdhër të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm, Sekretarit të Përgjithshëm;

f) Konkurrimi për vendin e punës në pozicionin Përgjegjës të Sektorit Prokurimit Publik; do të bazohet në:

- *Njohurite për Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë;*

- *Ligjin nr.97/2016, “Për organizimin e funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme;*

- *Kodin e Procedurave Administrative;*

- *Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 , “Për prokurimet publike”;*

- *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021, indryshuar me vendimin 710, datë 24.11.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike”;*

- *Vendimi nr. 486, datë 21.7.2022 “për përcaktimin e rregullave për pavlefshmërinë e kontratave të prokurimit publi”;*

- *Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike ”, i ndryshuar;*

- *Rregulloren e Brendshme të Prokurorisë së Përgjithshme;*

Lista e dokumentave që duhet të dorëzohen, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet njoftimit. Mënyra e dorëzimit me postë ose e drejtperdrejte në protokollin e institucionit me adresë: Prokuroria e Përgjithshme/Sekretari i Përgjithshëm (konkurrimi për vendin e punës në pozicionin “Përgjegjës sektori”) me adrese: Rruga “Qemal Stafa, nr.1, Tirane.

g) Afati i dorezimit te dokumentave eshte data **01.04.2024**, i cili eshte jo me vone se 30 dite kalendarike nga dita e pare e shpalljes ne faqen elektronike e Prokurorisë së Përgjithshme. Per dokumentat qe dorezohen me poste data e dorezimit eshte ajo e vules postare ne momentin e pranimit te objektit postar.

l) Konkurrimi per vendin e punes ne pozicionin “përgjegjës sektori” do te zhvillohet te Prokuroria e Përgjithshme, salla e mbledhjeve ne adresen: Rruga “Qemal Stafa nr.1, Tirane.

m) Menyra e vleresimit te kandidateve:

- Vleresimi i jeteshkrimit te kandidateve, qe konsiston ne vleresimin e arsimimit, te eksperiences e te trajnimeve, te lidhura me fushen, si dhe vleresimet e arritjeve vjetore;

- Vleresimi me shkrim;

- Intervista e strukturuar me gojë.

- Totali i pikëve te vleresimit te kandidateve eshte 100, te cilat ndahen perkatesisht:

÷ Per vleresimin e jeteshkrimit (cv) te kandidateve, qe konsiston ne vleresimin e arsimimit, te eksperiences e te trajnimeve, te lidhura me fushen, si dhe vleresimet e arritjeve vjetore, 20 pike;

÷ Per intervisten e strukturuar me goje,40 pikë;

÷ Per vleresimin me shkrim, 40 pikë.

- Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet do te behet nepermjet adresave te e-mail-ve, me mesazhe ne numrin e celularit, ne faqen e internetit.

- Per me shume informacion per Prokurorinë e Përgjithshme dhe veprimtarine e saj mund te vizitoni edhe faqen tone ne internet: www.pp.gov.al.

PROKURORIA E PERGJITHSHME

TIRANE MË 05.03.2024